



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 67, datë 25.09.2024

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:

“NDËRTIMI I GODINAVE TË REJA NË SPITALIN PSIKIATRIK “SADIK DINÇI”, ME 2,
3 KATE MBI TOKË DHE 1 KAT NËNTOKË”, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË
ELBASAN

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të zhvilluesit Spitalit Psikiatrik “Sadik Dinçi” Elbasan, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Ndërtimi i godinave të reja në Spitalin Psikiatrik “Sadik Dinçi”, me 2, 3 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë”, me vendndodhje në Bashkinë Elbasan, me zhvillues Spitalin Psikiatrik “Sadik Dinçi” Elbasan.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave i bashkëlidhet këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet kërkuesit vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Elbasan.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

ALBANA KOÇIU



ANËTAR/SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 21/05 2025